

Ekskluzive

Ekskluzive | Ky është i dyshuari për plagosjen me armë në Brus të Lipjanit – Policia në kërkim të 24-vjeçarit



Sinjali.com

25 Korrik 2026 10:00



Sinjali raportoi ekskluzivisht për plagosjen me armë zjarri që ndodhi në fshatin Brus të Lipjanit. Tashmë janë bërë të ditura edhe detaje të reja për rastin.

Burimet e **Sinjalit** bëjnë të ditur se personi që dyshohet për plagosjen është **Shpat Makolli rreth 24-vjeçar** nga fshati Marec, i cili vazhdon të jetë në arrati.

Sipas informacioneve të siguruara nga **Sinjali**, ngjarja ndodhi më 24 korrik, rreth orës 19:30, kur Policia mori njoftim për të shtëna me armë zjarri në fshatin Brus.

Bazuar në të dhënat e mbledhura në vendin e ngjarjes, nga të shtënat mbeti i plagosur në këmbë **Alban Gashi rreth 26-vjeçar**. Ai u dërgua për trajtim mjekësor në Spitalin e Gjilanit, ku pas marrjes së ndihmës është liruar.

Në vendin e ngjarjes kanë dalë njësitë e Hetimeve dhe Forenzikës Rajonale, të cilat kanë kryer veprimet e nevojshme hetimore, ndërsa për rastin është njoftuar edhe Prokurori i Shtetit.

Rasti është iniciuar për veprat penale “Vrasje e rëndë në tentativë” dhe “Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve”, ndërsa Policia po vazhdon kërkimin për arrestimin e të dyshuarit Shpat Makolli.

Shënim: Personat e apostrofuar në këtë artikull prezumohen të pafajshëm derisa fajësia e tyre të mos provohet me vendim të formës së prerë nga gjykata.

Sinjali – aty ku e vërteta flet para lajmit!

/GazetaSinjali/

Sinjali

Gazeta Sinjali mirëmbahet nga kompania "Sinjali" sh.p.k. Materialet dhe informacionet e Gazetës Sinjali nuk mund të kopjohen, të shtypen, ose të përdoren në çfarëdo forme tjetër, pa leje nga redaksia.



Lajme

Zgjedhjet 2026
Kosovë
Shqipëri
Rajon
Diasporë
Evropë
Botë

Aktualitet

Politikë
Drejtësi
Siguri
Shëndetësi
Arsim
Sociale

Hulumtime

Ekskluzive
Profile
Skandaloze

Ekonomi

Prodhime Vendore
Financa
Biznes

Sport

Botërori 2026
Futboll
Basketboll
Sporte Luftarake
Sporte të tjera

Showbiz

Bota e Yjeve
Modë & Stil
Bukuri dhe kujdes
Të tjera

OP-ED

Analizë
Kolumne
Intervistë

Jetë

Fitnes
Ushqime
Travel
Këshilla
Receta
Dieta
Shëndeti

Kulturë

Film
Muzikë
TV & Radio
Libra
Art & Dizajn
Fotografi
Histori

Tech & Auto

Teknologji
Automjete
Telefona
Internet
Lojëra
Aplikacione

Fun

Qesharake
Kuriozitete
Kuize
Fakte
Të tjera